

VENDIM
Nr.487, datë 16.7.2004

**PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA
MJEDISEVE TË BAZËS NDIHMUESE NË SARANDË DHE BAZËS NDIHMUESE NË
SHËNGJIN NGA MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË
USHQIMIT, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të ofiçinës mekanike, me sipërfaqe 360 m², të bankinës së shkallës KS, me sipërfaqe 62 m², dhe trullit funksional të tyre, me sipërfaqe 2498 m², komponente të bazës ndihmuese në Sarandë, si dhe mjediseve të bankinës KS, me sipërfaqe 323 m², e truallit funksional të saj, me sipërfaqe 1699 m², komponente të bazës ndihmuese në Shëngjin, sipas genplaneve që i bashkëlidhen këtij vendimi, t'u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë nga Ministria e Mbrojtjes e Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, për t'u përdorur për zbatimin e projektit pilot të zhvillimit të peshkimit, financiar nga Banka Botërore.

2. Nga pronat me numrat rendorë 696 “Baza ndihmuese” në Sarandë dhe 974 “Baza ndihmuese” në Shëngjin, që janë në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të hiqen pronat dhe sipërfaqet e truallit të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano